



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 38
Prishtinë, më 08. 06. 2010, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Ramë Buja, Nexhat Daci, Enis Kervan, Ismet Beqiri, Ibrahim Gashi dhe Ardian Gjini

Nga pjesëmarrësit e tjerë: Lejla Selimi – OSBE dhe Lumnije Murati – ZPRK.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 12 maj 2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe për Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 12 maj 2010

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 12 maj 2010, u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe për Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës

Sabri Hamiti njoftoi se për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe për Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, është shpërndarë propozimi i grupit të punës, për të cilin do të raportojë referuesi i grupit Ibrahim Gashi.

Komisioni, pas shqyrtimit të amendamentit të grupit të punës dhe eventualisht të ndonjë amendamenti tjetër, raportin do t'ua dërgojë komisioneve të përhershme për shqyrtim nga fushëveprimi i tyre.

Ibrahim Gashi në emër të grupit të punës diskutoi për ndryshimet që janë paraparë në nenet 1 dhe 2 të Projektligjit. Në vazhdim tha se është propozuar një amendament, në nenin 2 të Projektligjit, që i referohet nenit 7, në paragrafët 7.2, 7.3, dhe 7.6 formulimi “**Komisioni për Marrëdhënie me Jashtë i Kuvendit të Republikës së Kosovës**” të zëvendësohet me formulimin “**Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës**”.

Deputetët Ardian Gjini, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Ramë Buja, Ismet Beqiri e Enis Kervan, shqyrtuan pikën 2.4 të nenit 1 të Projektligjit, rreth zotërimit të gjuhëve të huaja për punën në shërbimin e jashtëm, dhe vendosën të mbetet varianti i propozuar në Projektligj.

Komisioni e shqyrtoi amendamentin e propozuara nga grupi i punës dhe e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet amendamenti i propozuar nga Grupi i punës në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe për Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, si vijon:

Amendamenti 1

Në nenin 2 të Projektligjit që i referohet nenit 7, në paragrafët 7.2, 7.3, dhe 7.6 formulimi “**Komisioni për Marrëdhënie me Jashtë i Kuvendit të Republikës së Kosovës**” të zëvendësohet me formulimin “**Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës**”.

4. Të ndryshme.

Sabri Hamiti rreth organizimit të takimit nga Kuvendi dhe Komisioni për Punë të Jashtme, me komisionet e jashtme të vendeve të rajonit, njoftoi se nga kontaktet që janë bërë, mbajtja e këtij takimi është përkrahur nga Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Mali i Zi e Maqedonia.

Temë e trajtimit do të jetë bashkëpunimi rajonal dhe integrimet evropiane.

Nexhat Daci e përkrahu mbajtjen e takimit me komisionet homologe të vendeve të rajonit, me ç’ rast mendon se duhet të ftohen të gjitha vendet e rajonit, edhe Serbia, dhe mundësisht ky takim të organizohet në ndonjë vend relaksues jashtë qytetit të Prishtinës.

Ibrahim Gashi gjithashtu përkrahu mbajtjen e këtij takimi, njëkohësisht e dha idenë e involvimit të NDI –së për ndihmë teknike rreth organizimit të takimit.

Sabri Hamiti shtoi se çështja e takimit është ende e hapur, për këtë takim do të kontaktohet edhe përfaqësuesi i BE- së, në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 35.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit